



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 49

Tiranë – E hënë, 27 mars 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 18/2023, datë 23.2.2023	Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore. 5297
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 9, datë 21.3.2023	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”..... 5300
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 142, datë 21.3.2023	Për delegimin e kompetencave..... 5301
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 24.2.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në gjirin e Vlorës..... 5302
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 24.2.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”..... 5303
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 24.2.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 5305
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 24.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 5306
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 24.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 5307
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 40/7, datë 21.3.2023	Për shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike ‘Faza V, fshati Mbyet, Njësia Administrative Portëz’”..... 5308
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 169/6, datë 21.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Apulia’ (paralel me linjën hekurudhore – plazh)”..... 5310



LIGJ
Nr. 18/2023

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË
PRIVATIZIMIT TË OBJEKTEVE
TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i fushës së zbatimit, autoriteteve përgjegjëse për përfundimin e procesit të privatizimit dhe procedurën e privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe trojeve të tyre funksionale.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurat dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe trojeve të tyre funksionale për të cilat ky proces nuk ka përfunduar, si dhe të transferimit të pronësisë së tyre te subjektet blerëse.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. “Ministri” ose “ministria” është ministri ose ministria përgjegjëse për bujqësinë.
2. “Përfundimi i procesit të privatizimit” është kalimi i pronësisë së pronës shtetërore të ish-ndërmarrjeve bujqësore te subjektet përfituese.
3. “Ish-ndërmarrja bujqësore” i referohet ndërmarrjes bujqësore sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi deri në datën 1.8.1991.

4. “Objekt i ish-ndërmarrjeve bujqësore” janë ndërtesat për të cilat ka filluar, por nuk është përfunduar me dokumentacion të rregullt apo të plotë procesi i privatizimit me ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të shfuqizuar, ose procesi i shitjes nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të shfuqizuar.

5. “Subjekt” janë individët të cilët posedojnë objektet dhe njëkohësisht zotërojnë një nga këto cilësi:

a) janë përfitues të drejtpërdrejtë që identifikohen në bazë të dokumentacionit të privatizimit sipas legjislacionit të kohës së privatizimit;

b) janë trashëgimtarë të tyre (të përfituesve të identifikuar në bazë të dokumentacionit të privatizimit sipas legjislacionit të kohës së privatizimit);

c) janë të tretë të cilët kanë lidhur marrëveshje noteriale me individët e përcaktuar në shkronjat “a” ose “b” të kësaj pike, me qëllim kalimin e të drejtave mbi objektin apo të së drejtës për ta përfituar atë.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Në fushën e zbatimit të këtij ligji përfshihen objektet e ish-ndërmarrjeve bujqësore, procedura e privatizimit ose shitjes së të cilave ka nisur, por nuk është përfunduar, ose përmban mangësi në dokumentacion sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) objekte për të cilat ka përfunduar procesi i vlerësimit, likuidimit dhe pajisjes me kontratë shitjeje nga ish-Agencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore sipas vendimit nr. 161, datë 8.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, dhe vendimit nr. 510, datë 26.10.1993, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin e mjeteve themelore, pasuri shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, por jo të nënshkruara para noterit;



b) objekte për të cilat ka përfunduar procesi i vlerësimit dhe pajisjes me kontratë, por me likuidime të pjesshme ose të papaguara të vlerës së kontratës dhe jo të nënshkruara para noterit;

c) objekte për të cilat ka përfunduar procesi i vlerësimit nga ndërmarrja dhe është kryer likuidimi i plotë, por nuk është pajisur me kontratë shitjeje nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;

ç) objekte për të cilat ka përfunduar procesi i vlerësimit nga ndërmarrja dhe është kryer likuidimi i pjesshëm, por nuk është pajisur me kontratë shitjeje nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;

d) objekte për të cilat nga ish-Drejtoria e Ndërmarrjeve të Braktisura është hartuar një aktdorëzim i objekteve, dorëzuar personave privatë dhe për të cilat është bërë një vlerësim sipas akteve në fuqi për privatizimin.

2. Fusha e zbatimit të këtij ligji shtrihet edhe mbi truallin funksional të objekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni në rastet kur ky truall nuk është privatizuar më parë, është ende në pronësi shtetërore, si dhe nuk përbën pronë publike të patjetërsueshme në kuptim të legjislacionit për pronat e paluajtshme të shtetit. Në fushën e zbatimit përfshihen edhe rastet kur për këtë truall është lidhur kontratë shitjeje pa akt noterial mes subjektit dhe AQRPN-së.

3. Në fushën e zbatimit të këtij ligji nuk përfshihen:

a) objektet shtetërore të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, të cilat aktualisht janë të paprivatizuara;

b) trojet e paprivatizuara për të cilat nuk ka asnjë kontratë shitjeje, qoftë edhe pa akt noterial, nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore dhe që janë në funksion të objekteve të privatizuara.

Neni 5

Kusht përjashtues

1. Objektet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji, trajtohen sipas kreut II të tij duke përfunduar procedurat e privatizimit vetëm në rast se aktet përkatëse të privatizimit/shitjes nuk janë regjistruar më parë në regjistrat kadastralë në favor të subjekteve përfituese të tyre.

2. Kur aktet e privatizimit/shitjes së objekteve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, pavarësisht mangësive ose jo në procedurë e dokumentacion, janë regjistruar më parë në regjistrat kadastralë në favor të subjekteve përfituese, ose kur pasuritë janë tjetërsuar tek të tretët, nuk zbatohen procedurat sipas kreut II të tij. Në këto raste merret i mirëqenë regjistrimi i mëparshëm i tyre dhe procedohet nga ASHK-ja si më poshtë:

a) kur objekti figuron i regjistruar në regjistrat kadastralë dhe i tjetërsuar tek të tretët, edhe nëse nuk ka akt të origjinës së fitimit të pronësisë (akti i privatizimit/shitjes) apo ai nuk është në formën e kërkuar nga ligji (pa akt noterial), ASHK-ja vijon me kalimin e pronësisë së truallit për subjektin që ka pronësinë mbi ndërtesën sipas të njëjtave rregulla të parashikuara në nenet 62 dhe 63, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) kur objekti figuron i regjistruar në regjistrat kadastralë në emër të përfituesit të privatizimit/shitjes edhe nëse dokumentacioni i privatizimit/shitjes nuk është i plotë apo nuk është në formën e kërkuar nga ligji (pa akt noterial), ASHK-ja vijon me kalimin në pronësi të truallit shtetëror në përdorim sipas të njëjtave rregulla të parashikuara në nenet 62 dhe 63, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

c) kur pasuritë, objekt (ndërtesë) dhe truall figurojnë të regjistruara në regjistrat kadastralë ende në pronësi të përfituesit të parë të tyre, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, por akti i privatizimit/shitjes nuk është sipas formës së kërkuar nga ligji (pa akt noterial), vijohet me trajtimin e kërkesës për shërbime kadastrale të përfituesit. I njëjti rregull zbatohet edhe kur trualli dhe objekti janë tjetërsuar dhe regjistruar në pronësi të të tretëve, edhe nëse nuk ka akt të origjinës së fitimit të pronësisë (akti i privatizimit/shitjes).

Në të gjitha rastet e sipërpërmendura ASHK-ja heq nga regjistrat kadastralë kufizimet e vendosura më parë mbi pasuritë.



KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURA

Neni 6

Parimet e procesit

Veprimtaria administrative për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve dhe trojeve të tyre funksionale sipas këtij ligji udhëhiqet nga parimet bazë të sigurisë juridike, shtetit të së drejtës, transparencës, ligjshmërisë, barazisë e mosdiskriminimit dhe objektivitetit.

Neni 7

Autoritetet përgjegjëse për përfundimin e procesit të privatizimit

Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor janë autoritetet publike përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, me qëllim përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe trojeve të tyre funksionale.

Neni 8

Subjektet përfituese

1. Subjektet përfituese për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe trojeve të tyre funksionale duhet të plotësojnë sipas rastit këto kushte:

a) për objektet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, subjekti duhet të paraqesë kontratën e shitjes së objektit të privatizuar ku të figurojë palë blerëse;

b) për objektet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, subjekti duhet të paraqesë kontratën e shitjes së objektit të privatizuar, ku të figurojë palë blerëse dhe mandat arkëtimi për likuidimin e pjesëshëm të vlerës së privatizimit të objektit;

c) për objektet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, subjekti duhet të paraqesë mandat arkëtimi për likuidimin e plotë të vlerës së privatizimit të objektit;

ç) për objektet e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, subjekti duhet të

paraqesë mandat arkëtimi për likuidimin e pjesëshëm të vlerës së privatizimit të objektit;

d) për objektet e parashikuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji, subjekti duhet të paraqesë akt dorëzimi të objektit për të cilin është bërë një vlerësim sipas akteve në fuqi për privatizimin.

2. Në rastet kur subjekti përfitues ka një nga cilësitë e parashikuara në shkronjat “b” ose “c”, të pikës 5, të nenit 3, të këtij ligji, ai duhet të paraqesë, përveç dokumenteve të sipërpërmendura, edhe dëshminë e trashëgimisë ose aktin noterial që vërteton njohjen/kalimin e të drejtave.

Neni 9

Procedura për përfundimin e privatizimit

1. Për objektet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji ndiqet procedura e mëposhtme:

a) subjektet paraqesin kërkesën për përfundimin e procesit të privatizimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku identifikojnë objektin për të cilin kërkohet përfundimi i procesit të privatizimit. Ministria brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga paraqitja e kërkesës njofton Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për depozitimin e dokumentacionit;

b) Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendrike nga kërkesa paraqet në ministri dokumentacionin e procesit të privatizimit për objektin dhe truallin funksional. Dokumentacioni vlerësohet nëse është i rregullt nga struktura përgjegjëse për privatizimin në ministri, e cila kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve;

c) kontrata e shitjes nënshkruhet nga titullari i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në territorin e të cilit ndodhet objekti, pas autorizimit të dhënë nga ministri përgjegjës për bujqësinë, sipas legjislacionit në fuqi për shitjen e pasurive të paluajtshme.

2. Format i kontratës së shitjes miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Dokumentacioni për përfundimin e procesit të privatizimit, mënyrën e përlogaritjes së vlerës së pagesës së mbetur dhe afatet e pagesës së privatizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe financat.



Neni 10

Kontrata e shitjes regjistrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës në bazë të kërkesës së subjektit përfitues në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.

Neni 11

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.

Neni 12

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, çdo akt që bie në kundërshtim me të shfuqizohet.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 23.2.2023.

UDHËZIM

Nr. 9, datë 21.3.2023

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN
NR. 17, DATË 5.7.2022, “PËR VLERËSIMIN
E NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, pas nenit 9, të shtohen neni 9/1 dhe neni 9/2 me përmbajtje, si më poshtë:

Neni 9/1

**“Vlerësimi i nxënësve në shkollat e
orientuara të drejtimit artistik”**

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Për të gjitha lëndët e kurrikulës artistike, vlerësimi realizohet në dy periudha, si më poshtë:

- periudha e parë: shtator – janar;
- periudha e dytë: shkurt – qershor.

3. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve për lëndët e kurrikulës artistike sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë” dhe “Koreografi”, të jetë si më poshtë:

Periudha e parë		Periudha e dytë		Vlerësimi vjetor		Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (saxho)	



4. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

5. Procedura për përlogaritjen e notës përfundimtare vjetore, është:

a) nota vjetore e vlerësimit të vazhduar teknik përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teknik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

b) nota vjetore e detyrës përmblendhëse (saxho) përcaktohet bazuar në dy notat e detyrës përmblendhëse (saxho) të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

c) nota përfundimtare përcaktohet bazuar në notën vjetore të vlerësimit të vazhduar teknik dhe notën vjetore të detyrës përmblendhëse (saxho).

6. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve për lëndët e kurrikulës artistike, sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik, në degën “Art figurativ”, është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	

7. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

8. Nota përfundimtare përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teorik dhe praktik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.

9. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë”, “Koreografi” dhe “Art figurativ” vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

Neni 9/2

“Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit sportiv”

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit sportiv vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 142, datë 21.3.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, për ndjekjen e procedurave për financimin e projekteve në fushën e sportit, propozuar nga federatat joolimpike, sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 25.2.2022, “Për mënyrën e përdorimit të fondit ‘Grant/transferte korrente e brendshme’ për federatat sportive olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping”.

2. Kompetencat e deleguara ushtrohen deri në përfundimin e procedurës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, për vitin 2023.



3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

VENDIM
Nr. 55, datë 24.2.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË KESH SHA PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-i I
LUNDRUESHËM I INSTALUAR NË
PORTIN E TRIPORTIT NË GJIRIN E
VLORËS**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 305/5 prot., datë 23.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 mw.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 30.12.2022 dhe 31.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.1.2023) nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 2074/3 prot., datë 30.12.2022, dhe nr. 308/2 prot., datë 7.1.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. KESH sh.a. me shkresën nr. 37/4 prot., datë 31.1.2023, protokolluar në ERE nr. 308/1 prot., datë 1.2.2023, ka depozituar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

- ERE, me shkresën nr. 308/3 prot., datë 10.2.2023, i është drejtuar me kërkesë për informacion edhe OST sh.a., në lidhje me statusin e nënshkrimit të marrëveshjes së pikës së lidhjes së TEC-it me rrjetin e transmetimit, për të cilën nuk kemi ende një përgjigje, si dhe aktualisht rezulton që KESH sh.a. ka bërë aplikimin për pajisjen me lejen e përdorimit të burimit uxor nga AMBU-ja.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kushtet kur shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE “Miratimin në parim për pikën e lidhjes së dy njësive gjeneruese termike lundruese me rrjetin e transmetimit në zonën e Vlorës, Bashkia Vlorë” dhe është në proces të nënshkrimit



të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin me OST sh.a., për të sqaruar me shoqërinë mungesat e konstatuara, për sa i përket nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin me OST sh.a. dhe pajisjen me lejen e përdorimit të burimit ujor nga AMBU-ja, vlerësohet të zgjatet me 30 ditë pune afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s.

- Lidhur me shtyrjen e vendimmarrjes, në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor”.

- Po ashtu, “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, në nenin 14 pika 3, të saj përcakton, se: “3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjietike shqiptare (KESH)” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 56, datë 24.2.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-i “SHKOPET”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133/2 prot., datë 23.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a. për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2023, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria ‘Kurum International’ sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i ‘Shkopet’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 351, datë 28.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” me kapacitet të instaluar 24 mw.

- Në vijim, ERE me shkresën me nr. 133 prot., datë 16.1.2023, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije se, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,



transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 133/1 prot., datë 15.2.2023, brenda afatit të sipërcituar (shkresa e ERE-s nr. 133 prot., datë 16.1.2023, është marrë nga shërbimi postar në datën 16.1.2023 dhe duke llogaritur afatin tre ditor të dërgimit të saj mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative, rezulton se shoqëria ka marrë dijeni për këtë shkresë në datën 19.1.2023). Me shkresën e sipërcituar shoqëria ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për modifikimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Aplikuesi bën me dije se kërkesa për modifikim ka ardhur për arsye se në maj 2023 kjo shoqëri ka programuar rehabilitimin e HEC “Shkopet”, “optimizimi i operimit të turbinave”, gjatë të cilit do të zëvendësohen disa nga pajisjet kryesore të centralit dhe do të instalohen pajisje të reja dhe do të ketë një shtesë kapaciteti prej 4 mw dhe fuqia nominale do të jetë $P_n=28$ mw.

Duke qenë se rritja e kapacitetit të instaluar si më sipër, tejkalon kufirin e përcaktuar në pikën 2.3 të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, e cila përcakton se: çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj licence, atëherë kërkesa e shoqërisë “Kurum International” sh.a. i nënshtrohet vendimmarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës.

- Me vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011 “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Ulez – Shkopet’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulez dhe Shkopet”, dhe nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, licencat që mbanin shoqëritë “HEC Ulez – Shkopet” sh.p.k. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.p.k. janë transferuar te shoqëria “Kurum International” sh.a.

- Me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013, “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë ‘HEC Ulez – Shkopet’ sh.a. të lidhur ndërmjet METE-s (sot MIE) dhe shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a...”, është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria “HEC Ulez – Shkopet” sh.p.k. te shoqëria “Kurum International” sh.a., duke kaluar HEC “Shkopet” në pronësi të “Kurum International” sh.a.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Kurum International” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, geramat “a”, “b”, “d” dhe “e”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni në vijim:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të shoqërisë në të cilin shprehet vullneti i tij për këtë modifikim.

- germa “f”: Duke marrë shkas nga shkresa e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) se shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. mund të vijojë me lejen që disponon për shfrytëzimin e burimit ujor nëse nuk ka ndryshim të parametrave të shfrytëzimit hidrik, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka respektuar me rigorozitet lejen aktuale që disponon dhe nëse e njëjta sasi uji mjafton dhe për prodhimin e energjisë elektrike për kapacitetin prej 28 mw.

- germa “g”: Në vijim të sa depozituar, shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe miratimin përfundimtar për lidhjen me rrjetin nga OST sh.a. për kapacitetin për të cilin kërkohet dhe modifikimi i licencës.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licences nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” me kapacitet të instaluar 24 mw, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 MW

Bëhet: kapaciteti i instaluar 28 MW

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 57, datë 24.2.2023

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “TPLANI
HC” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe

nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/11 prot., datë 23.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 27.1.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrale “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.1.2023 dhe 1.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 99/6 prot., datë 7.2.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 99/7 prot., datë 9.2.2023, nr. 99/8 prot., datë 15.2.2023, si dhe nr. 99/9, datë 17.2.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtijshme me shoqërinë, me qëllim që të saktësohen me shoqërinë disa dokumente në kuadër të këtij aplikimi, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë)



ditë afati i vendimarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 58, datë 24.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 567/3 prot., datë 23.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k./në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 24, datë 9.2.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të vendimarrjes për mosfillimin e procedurës, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567/2 prot., datë 15.2.2023, ka përcjellë dokumentacion plotësues brenda afateve që përcakton neni 10, pika 7, i “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Ndërkohë, ERE me shkresën nr. 567/3 prot., datë 22.2.2023, njoftoi shoqërinë se dokumentacioni i përcjellë prej saj do të shqyrtohej për t’u vlerësuar në vendimarrjen e radhës.

- Në vijim të protokollimit të relacionit nr. 567/3 prot., datë 23.2.2023, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, në ERE mbërriti shkresa nr. 567/4 prot., datë 23.2.2023 “Plotësim dokumentacioni”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka përcjellë dokumentacion financiar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c”; për pikën 2.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se është plotësuar pjesërisht dokumentacioni në vijim:

Pika 1.3 “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të paraqesë në ERE vendimin e Asamblesë së Ortakëve të saj në lidhje me vlerën financiare që do të vejë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, llogaritur kjo, sipas sasive që ka parashikuar të furnizojë, të shoqëruar me vërtetim të gjendjes së llogarisë për disponueshmërinë e shumës që nevojitet për garantimin e të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të

rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 59, datë 24.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/1 prot., datë 23.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Energy Market Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 877 prot., datë 16.02.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Duke qenë se konstatohet se vërtetimi për administratorin e shoqërisë është i lëshuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në vijim do t'i kërkohej që në rast se administratori është rezident në Shqipëri, të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore të lëshuar këtu.

- germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj në zbatim të kësaj pike të rregullores.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Duke qenë se shoqëria rezulton debitore ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, në vijim ajo duhet të bëjë me dije se si ka vijuar procesi i shlyerjes së detyrimit.

- germa “b”: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE disponimin e shumës që nevojitet për



ushtrimin e veprimtarisë, si dhe të depozitohet pasqyrat financiare për vitet 2021 dhe 2022.

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitohet në ERE Planin e Biznesit.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Për dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitohet atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 40/7, datë 21.3.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i varrezave publike ‘faza V, fshati Mbyet, Njësia Administrative Portëz’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni pronarët e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “arë”, ku për zonën kadastrale 2637, çmimi për m², rezulton 269 lekë/ m², si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000 “Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”, për “kulturat bujqësore”.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 27,009,294 (njëzetë e shtatë milionë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



VLERËSIM PËR PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR INTERES PUBLIK: “PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE FAZA V, FSHATI MBYET, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ”

Nr.	EMËR ATËSIA MBIEMËR	Zona Kad.	NR. Pas.	Lloji i pasurisë	Sip. Totale e TOKES ARË TOTAL(m2)	Sip. e TOKES ARE QE PREKET nga shpronësimi (m2)	ÇMIMI I TOKES ARE leke/m2	VLERA E TOKES ARE	Vlera e Drureve te mbjelle	VLERA TOTALE	KONFIRMUAR NGA ASHK
1	VELI SELIM TAHIRI	2637	288/32	arë	2850	2850	269	766,650		766,650	I PAPAJSISUR ME CERTIFIKATË PRONËSIE
2	SHEFQET SELIM TAHIRI	2637	288/36	arë	1088	1088	269	292,672	1,067,240	1,359,912	I PAPAJSISUR ME CERTIFIKATË PRONËSIE
3	MYSAFER MALIQ HOXHAI NIAZIE NOVRUZ HOXHAI	2637	288/125	arë	3065	3065	269	824,485	3,148,120	3,972,605	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
4	MYNYR MEHMET ALIAJ	2637	288/112	arë	1500	1500	269	403,500	1,387,000	1,790,500	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
5	LAVER HEKURAN HOXHAI	2637	288/38	arë	4000	4000	269	1,076,000	4,046,930	5,122,930	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
6	OSMEN IBRAHIM HOXHA	2637	288/46	arë	1755	1755	269	472,095	674,220	1,146,315	I PAPAJSISUR ME CERTIFIKATË PRONËSIE
7	BARJAM MALIQ HOXHA	2637	288/47	arë	1989	1989	269	535,041	840,600	1,375,641	I PAPAJSISUR ME CERTIFIKATË PRONËSIE
8	MALIQ IBRUSH HOXHA	2637	288/48	arë	1142	1142	269	307,198		307,198	I PAPAJSISUR ME CERTIFIKATË PRONËSIE
9	NEIM FERIK TAHIRI	2637	288/49	arë	8372	8372	269	2,252,068	8,915,475	11,167,543	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT						25,761	269	6,929,709	20,079,585	27,009,294	

Vlerësimi i tokës "arë" është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “arë”, ku për zonën kadastrale 2637, çmimi për m², rezulton 269 lekë/ m²

Vlerësimi i “kulturat bujqësore” është llogaritur bazuar në udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000 “Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shërbërjes”.

**KËRKESË****Nr. 169/6, datë 21.3.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Apulia’ (paralel me linjën hekurudhore – plazh)”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Durrës.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni pronarët e prekur nga ky shpronësim,

për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, ku për zonën kadastrale 8518, çmimi për m², rezulton 19,336 lekë/m².

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 21,411,719.6 (njëzet e një milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi



LISTA PARAPRAKE E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘APULIA’
(PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË			SHËNIME
												Shpronësim tokë “truall”			
	Emër	Atësi	Mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. tot.	Truall	Ndërtesë	Volum	Faqe	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	
1	Shtet			8518	43/194	Truall	1246			111	146	252	-	-	D- Nr. dok. 28090, datë regj. 5.8.2016. Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa nr. 43/29/nd. vol. 122 f. 32.
2	Shtet			8518	43/123	Truall	434			97	63	50	-	-	E- Okupuar nga Myscret Gjindi, ndërtim pa leje
3	Shtet			8518	45/111	Truall	29			97	210	0	-	-	
4	Shtet			8518	45/106	Truall	277			97	205	4.45	-	-	E- Okupuar nga Lulzim Meka, ndërtim pa leje
5	Shtet			8518	45/112	Truall	776			97	211	40.1	-	-	E- Okupuar nga Nika Meka, ndërtim pa leje
6	Shtet			8518	45/121	Truall	204			97	220	48.1	-	-	E- Okupuar nga Agim Miraka, ndërtim pa leje
7	Shtet			8518	45/123	Truall	88			97	222	14	-	-	E- Okupuar nga Haki Behri, ndërtim pa leje
8	Shtet			8518	45/124	Truall	91			97	223	12.4	-	-	E- Okupuar nga Ethem Sehri, ndërtim pa leje
9	Shtet			8518	45/126	Truall	150			97	225	11.5	-	-	E- Okupuar nga Sakip Nesmi, ndërtim pa leje
10	Lejla	Teufik	Haznedari	8518	48/14	Truall	1967	1967		17	190	404	19,336	7,811,744	Titulli i pronësisë së kësaj pasurie përfshin edhe pasurinë 48/47 vol. 78 f. 98, e cila është kufizuar për mbivendosje me d. not. nr. 910/508, datë 1.3.2017 pajset me certifikate pronësie për pjesën e lirë me sip. 1967 m ref. 31065.
	Violeta	Teufik	Manushi												
	Hasan	Teufik	Kalatsi												
	Klebeta	Sabri	Kalatsi												
11	Denada	Sabri	Negollari	8518	48/20	Truall	3870	3870		45	155	214	19,336	4,137,904	D- Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa nr. 48/9/nd. vol. 127, f. 188.
	Arianita	Gezim	Hasa												
	Bujare		Hasa												
	Fatmir		Hasa												
	Kujtim		Hasa												
	Mynyre		Hasa												
	Neta		Hasa												
	Teuta		Starova												
Tomorr		Hasa													
12	Shtet			8518	48/28	Truall	23			90	140	1	-	-	E- Okupuar nga Perparim Veliaj, ndërtim pa leje.
13	Shtet			8518	48/30	Truall	374			90	136	5.9	-	-	E- Okupuar nga Ali Ruçi, ndërtim pa leje.
14	Shtet			8518	48/32	Truall	337			90	133	7.7	-	-	E- Okupuar nga Ramadan Ruçi, ndërtim pa leje.
15	Shtet			8518	48/31	Truall	763			90	134	14.9	-	-	E- Okupuar nga Naim Ibrahim, ndërtim pa leje.
16	Shtet			8518	48/38	Truall	365			90	91	20.3	-	-	E- Okupuar nga Sali Ruçi, ndërtim pa leje
17	Shtet			8518	48/39	Truall	311			90	89	15.8	-	-	E- Okupuar nga Qamil Paja, ndërtim pa leje
18	Shtet			8518	48/50	Truall	208			13	144	146.4	-	-	E- Okupuar nga Gezim Loto e Santionil Loto, ndërtim pa leje
19	Shtet			8518	48/48	Truall	489			17	193	31.4	-	-	E- Okupuar nga Gezim Loto e Santionil Loto, ndërtim pa leje
20	Shtet			8518	49/2	Truall	353			6	78	107	-	-	Okupuar nga Pal Ppe....., ndërtim pa leje
21	Drita		Paja	8518	48/51	Truall	300	300	0	78	90	6.1	19,336	117,949.6	E- 00080 datë regj. 10.10.2012. Kufizohen veprimet deri në plotësimin e dok. tekniko-ligjor
22	Kimete		Gjoka	8518	48/19	Truall	1065	1065		44	229	415	19,336	8,024,440	D- Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa vol. 132, f. 154
	Dhurata		Magjistari												
	Silvana		Leka												
	Maksim		Haxhiu												
	Merushë		Haxhiu												
	Fellenza		Koçi												
	Lumturi		Xhabija												
	Xheni		Agovi												
	Miguel		Magjistari												
	Elin		Magjistari												
	Martin		Magjistari												
David		Leka													
23	Kimete		Gjoka	8518	48/13	Truall	1200	1200		12	137	57	19,336	1,102,152	D- Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 48/92/nd. vol. 121 f. 197 në pronësi të Tahir Sharka me leje legalizimi
	Dhurata		Magjistari												



	Martin		Magjistari												
	Elin		Magjistari												
	Silvana		Leka												
	David		Leka												
	Maksim		Haxhiu												
	Merushe		Haxhiu												
	Fellenza		Koçi												
	Lumturi		Xhabija												
	Xheni		Agovi												
	Miguel		Magjistari												
24	Erton	Fuat	Çafaj	8518	43/225	Truall	345	345		136	43	11.25	19,336	217,530	D- U krye RVP datë 21.2.2020 për vlerën 6.670.920 lekë
	Emirjona	Nuri	Selimi												
25		Shtet		8518	45/208	Truall	18.3	18.3		122	127	15.6	-	-	
26		Shtet		8518	45/86	Truall	637			97	185	292	-	-	D- Nr. dok. 42285, datë regj. 11.2.2021 kërkesëpadi, proces gjyqësor
27		Shtet		8518	48/88	Truall	295	295		118	177	22.8	-	-	
Shuma totale														21,411,719.6	

Shënim

Vlerësimi paraprak i llogaritur, bazohet në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, ku për zonën kadastrale 8518, çmimi për m², rezulton 19,336 lekë/m².

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë